



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

...Numri i lëndës: 2018:007090  
Datë: 03.04.2024  
Numri i dokumentit: 05537518

**PAKR.nr.16/2024**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Beqir Kalludra, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Xhevdet Abazi, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Ardianë Morina, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit K.H., nga fshati ....., Komuna e Pejës, për shkak të veprave penale, vrasje e rëndë, nga neni 178 të KPK dhe mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesave, të Prokurorisë Themelore në Pejë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar M.Z., av.Gëzim Kollqaku, dhe mbrojtësit së të akuzuarit K.H., av.Besnik Berisha, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.108/18, të dt.30.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 18.03.2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

Me aprovimin e ankesave, të Prokurorisë Themelore në Pejë, dhe mbrojtësit së të akuzuarit K.H., av.Besnik Berisha, e sipas detyrës zyrtare, anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.108/18, të dt.30.11.2023, ashtu që çështja penale i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje.

Ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar M.Z., av.Gëzim Kollqaku, tani për tani është jo lëndore.

Me aktvendim të posaçëm të akuzuarit K.H., i vazhdohet paraburgimi, pasi që ende ekzistojnë kushtet ligjore.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.108/18, të dt.30.11.2023, është shpallur fajtor i akuzuari, K.H., për shkak të veprave penale, vrasje, nga neni 178 të KPK, dhe mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPK, dhe i janë shqiptuar dënimet:

-për veprën penale të përshkuar sikurse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) viteve, dhe

-për veprën penale të përshkuar sikurse në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Për të dy veprat penale i ka shqiptuar dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) vite e 6 (gjashtë) muaj burgim, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga data 06.03.2017, e gjerë në përfundim të mbajtjes së dënimit me burgim, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar.

I akuzuari është obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, të paguaj shumën prej 1.000 (një mijë) Euro, si dhe shumën prej 50 (pesëdhjetë) Euro, për taksën për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

E dëmtuara M.Z., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko - civil.

Në kuptim të nenit 374 par.3 të KPK, e lidhur me nenin 276 par.1 nën par.1.1 të KPPK, të akuzuarit K.H., i është shqiptuar dënimi plotësues – marrja e sendit/Konfiskimit, edhe atë:

-1 (një) armë “Pietro Beretta M-70”, e kal.7.65x17mm, dhe një elektroshok i tipit “Scorpion Plus”, të sekuestruara nga i akuzuari, me numrin e rastit 2017-DA-0500, të dt.07.03.2017, dhe urdhërohet shkatërrimi i tyre, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

- Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit për sanksionin penal, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet kurse çështja penale të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje, apo që i njëjti të ndryshohet dhe i akuzuar të shpallet fajtor për veprën penale sikurse ka qenë në aktakuzë,

-përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar – familjes Z., av.Gëzim Kollçaku, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, ose që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.108/18, të dt.30.11.2023, të ndryshohet dhe ndaj të akuzuarit të shqiptohet një dënim më i ashpër, dhe

-mbrojtësi i të akuzuarit K.H., av.Besnik Berisha, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljet e ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet, dhe i njëjti të shpallet fajtor për veprën penale të vrasjes së kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore, nga neni 180 të KPK, ose që çështja penale të anulohet dhe ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje. Si alternativë tjetër propozon ndryshimin e aktgjykimit dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë.

Prokuroria e Apelit, me shkresën PPA/I.nr.28/2024, të dt.19.01.2024, duke u sqaruar përkitazi me ankesat e ushtruara, nga ana e Prokurorisë Themelore në Pejë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar M.Z., av.Gëzim Kollçaku, dhe mbrojtësit së të akuzuarit K.H., av.Besnik Berisha, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.108/18, të dt.30.11.2023, aktgjykimit të ankimuar, si shkresave të tjera të lëndës, ka propozuar që ankesat e ushtruara, nga ana e Prokurorisë Themelore në Pejë, përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar M.Z., av.Gëzim Kollçaku, të aprovohen si të bazuara, kurse çështja penale të anulohet pasi që aktgjykimi i ankimuar të kthehet në rigjykim e vendosje, kurse ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit K.H., av.Besnik Berisha, të refuzohet si e pabazuar.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për dt.18.03.2024, dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar, përfaqësuesi i palës së dëmtuar M.Z., av.Gëzim Kollçaku, e dëmtuara M.Z., i akuzuari K.H., mbrojtësi i tij, av.Besnik Berisha, si dhe përfaqësuesi ligjor i tani të ndjerit M.Z1., prindi B.Z..

Nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit, edhe pse është njoftuar me rregull.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar M.Z., av.Gëzim Kollçaku, ka deklaruar se mbetet pranë ankesës së ushtruar dhe kërkon dënim sa më të ashpër, për të akuzuarin.

E dëmtuara M.Z., deklaron se i bashkëngjitet ndjekjes penale, dhe parashtron kërkesë pasurore juridike.

Pasi që ishte në seancë të kolegjit babai i tani të ndjerit M.Z1., B.Z., deklaron se e mbështet në tërësi fjalën e avokatit Gëzim Kollçaku dhe kërkon dënim më të ashpër.

Mbrojtësi i të akuzuarit K.H., av.Besnik Berisha, deklaron se mbetet në tërësi pranë ankesës së ushtruar, se ka prova të mjaftueshme që ditën kritike i mbrojturi K.H., është ballafaquar nga tani i ndjeri me fyerje, lëndime dhe deri tek momenti i shkrepjes së revoles, lidhur me borxhin dhe se është dëmtuar shumë dhe nuk ka pasur diçka të keqe me tani të ndjerin, e gjithashtu kërkon që kjo çështje penale të vendoset dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë.

I akuzuari K.H., thekson se e përkrah në tërësi mbrojtjen e ushtruar nga ana e avokatit.

Kolegji i kësaj gjykatë në kuptim të nenit 394 të KPPK, ka vlerësuar ankesat e ushtruara, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se:

Aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të tjera të cilat kushtëzojnë anulimin e tij.

Përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, ankesë ka ushtruar Prokuroria Themelore në Pejë, duke pretenduar se shkeljet esenciale konsistojnë në kuptim të dispozitave ligjore nga neni 384 të KPPK, e sidomos duhet pasur parasysh par.2 nën par.2.4 të KPPK, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptueshëm, i pa qartë, në kundërthënie me vetveten si dhe me arsyet e dhëna për çdo pikë të aktgjykimit, që nënkupton se është në kundërshtim me gjendjen faktike, apo me faktet vendimtare, të cilat janë dhënë në arsyetim të aktgjykimit. Gjykata me rastin e ri cilësimit juridike të veprës penale nga vepra penale e vrasjes së rëndë nga neni 179 par.1 nën par.1.6 të KPK, në veprën penale, nga neni 178 të KPK, është dashur që të ketë parasysh elementet karakteristike, për secilën lloj të veprës penale, ngase vepra penale e vrasjes së rëndë ka karakteristika të ndara nga vepra penale vrasje e rëndë, e sidomos duke pasur parasysh se akuza ka qenë e ngritur për pikën 1.6 të KPK, ku pa qëllim të përfitimit të dobisë pasurore, është privuar nga jeta personi tjetër, këtë çështje gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në masë të duhur. Gjykata në mënyrë jo të drejtë ka interpretuar dispozitën ligjore nga neni 359 par.2 të KPPK, sepse është dashur që të jep sqarime të qartë për të vërtetuar identitetin objektiv dhe subjektiv të aktgjykimit dhe aktakuzës, se aktgjykimi duhet të i referohet vetëm personit të akuzuar, dhe vetëm për veprën penale e cila është objekt i akuzues, kurse në rastin konkret gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale. Gjykata mund të bëjë ndryshimin e kualifikimit juridik, por vetëm atëherë kur të njëjtën e mbështet me provat materiale dhe personale, kurse në rastin konkret të njëjtët kanë munguar sepse është dhënë vetëm në mënyrë sipërfaqësore konstatimi se cili ka qenë motivi i kryerjes së veprës penale.

Po ashtu aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit K.H., av.Besnik Berisha, të cilat konsistojnë në kuptim të nenit 384 par.2 nën par.2.1, 2.2 dhe 2.7 lidhur me nenin 369 par.7 të KPPK, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në marrjen e vendimit gjyqësor dhe të drejtë. Se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyet kontradiktore të pa sakta dhe të pa mjaftueshme, përkitazi me propozimet e mbrojtësit së të akuzuarit K.H., për nxjerrjen e një

ekspertizë psikologjike dhe psikiatrike mbi gjendjen mendore të akuzuarit, në momentin e privimit nga jeta, tashmë të ndjerit M.Z1., gjykata e shkallës së parë një provë të tillë përkundër asaj që në kuptim të nenit 360 par.2 të KPPK, thekson që gjykata detyrohet që me ndërgjegje të vlerësoj çdo provë dhe një nga një në lidhje me provat e tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerr përfundim nëse fakti konkret është provuar në rastin konkret, një veprim të tillë gjykata e shkallës së parë nuk e ka ndërmarrë.

Nga kjo rezulton se është shkelur edhe parimi “indubio pro reo”, që është obligim i gjykatës që të gjitha faktet e prezantuara duhet të jetën të bazuara, në të kundërtën çdo provë e nxjerrë shkon në favor të të akuzuarit, e kjo është e paraqitur në nenin 3 par.2, 7 par.2, 8 par.2 dhe 9 par.1 të KPPK. Të gjitha arsyet të cilat janë kontradiktore e bëjnë aktgjykimin e pa qëndrueshëm dhe të pa qartë, për punë të mëtejme. Është evidente që në këtë çështje penale në bazë të raportit mbi gjendjen shëndetësore mendore të dt.28.07.2017, si dhe plotësimit të tij, të përpiluar nga ekspertët Dr.Jeton Zogaj, Dr.Arita Veselaj dhe Dr.Fahri Drevinja, janë konstatuar se në vazhdimësi nga mbrojtja e K.H.t, gjykata e shkallës së parë është dashur të përkujdeset që të bëjë një ekspertizë të re, për të konstatuar gjendjen e të akuzuarit K.H.. Në këtë çështje penale kualifikimi juridik nuk është adekuat përgjegjësisë penale - juridike, ngase i akuzuari veprën penale e ka kryer në tronditje të fortë mendore, e cila mund të konstatohet nga ana e ekspertëve. Që të gjitha veprimet të cilat janë propozuar të gjykata e shkallës së parë është dashur që ti vërtetoj dhe të vlerësoj se në këtë çështje penale me çfarë lloj veprë penale kemi të bëjmë a është vepra penale, vrasje e rëndë, vrasje, apo vrasje në afekt mendor, që rezulton nga të gjitha provat personale dhe materiale nga shkresat e lëndës. Po ashtu është dashur që të ketë parasysh që në këtë çështje penale të vërtetoj edhe elementin cilësues sipas të cilit e ka ngarkuar prokuroria, në cilat prova është mbështetur rikualifikimi juridik i veprës penale për të cilën është shpallur fajtor sipas aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e që të gjitha këto ti vlerësoj duke iu dhënë lidhje të pa shkëputur edhe me provat materiale, dhe për të ardhur në përfundim për ekzistimin e veprës penale.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas vërejtjeve të Gjykatës së Apelit, përkundër asaj që ka qenë e obliguar që të veproj sipas të njëjtave, sepse gjykata e shkallës së parë në kuptim të nenit 404 të KPPK, jep mundësinë që të eliminoj të gjitha kundërthëniet që janë në aktgjykim të gjykatës së shkallës së parë, që duke i eliminuar mangësitë përkitazi me shkeljet esenciale, me siguri që do të eliminohen dhe të metat me vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së prokurorisë dhe mbrojtësit së të akuzuarit K.H., av.Besnik Berisha, lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat konsistojnë në kuptim të nenit 384 të KPPK, për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394 të KPPK. Kolegji ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, nuk është i qartë, nuk është në harmoni me vetveten, si dhe është në kundërshtim me vetveten dhe arsyet e dhëna lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit, ngase nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare të cilat e karakterizojnë ekzistimin e veprës penale të vrasjes, nga neni 178 të KPK. Në këtë çështje penale rezulton se i

akuzuari K.H., është akuzuar për shkak të veprës penale të vrasjes së rëndë, nga neni 179 par.1 pika 1.6 të KPK, që si element kualifikues e ka fitimin e dobisë pasurore, por pa e vërtetuar se cila ka qenë shuma, si ka qenë mënyra e një transakcioni të paraqitur në mes të akuzuarit K.H., dhe tani të ndjerit M.Z1., si kanë qenë raportet e të njëjtëve dhe si është e mundur që këtu i akuzuari ka qenë me automjetin e të dëmtuarit. Po ashtu nuk është vërtetuar rrethana se i akuzuari a ka pasur me vete revole, apo të njëjtën e ka marrë nga ana e të dëmtuarit.

Nga shkresat e lëndës rezulton se i akuzuari, pasi që e ka vërejtur revolen te këtu i dëmtuari, ka pasur tronditje të fortë mendore, mirëpo e njëjta nuk është vërtetuar nga ana e ekspertëve përkatës, për të vërtetuar gjendjen momentale të akuzuarit në raport me viktimën. Po ashtu prokuroria pretendon se me këtë çështje penale është dashur që të vërtetohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari dhe të gjitha provat nga shkresat e lëndës, duhet të kenë lidhje njëra me tjetrën dhe të reflektojnë me tërë çështjen penale e cila dhe është dashur që të përmblihet në dispozitiv të aktgjykimit, e më pastaj të jepen arsyet të qarta dhe të plota. Çështjet e ngritura nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit se të gjitha provat të cilat janë kontestuese duhet të shkojnë gjatë interpretimit në favor të akuzuarit, gjykata e shkallës së parë, dhe ashtu e ka obligim ligjor që të venë në disponim profesionalizimin dhe vlerësimin e të gjitha provave në mundësinë e aplikimit të parimit “indubio pro reo”. Po ashtu për shkeljet për të cilat pretendon mbrojtësi i të akuzuarit, në kuptim të nënti 384 par.2 nën par.2.1, 2.2 dhe 2.7 lidhur me nenin 369.7 të KPPK, gjykata e shkallës së parë edhe ashtu e ka obligim ligjor që të njëjtët ti respekton dhe atë të vendos për të gjitha propozimet e ngritura nga ana e mbrojtjes, të cilat janë të rëndësishme për të ndriçuar gjendjen faktike, si dhe të ketë parasysh që aktgjykimi të jetë i hartuar në kuptim të nenit 369 pika 7 të KPK. Kur e ngritim këtë çështje duhet të kihet parasysh që çdo aktgjykim duhet të përmbajë formën e paraparë me shkrim nga dispozita ligjore e nenit 369 të KPPK, duke i përmbajtur të gjitha pjesët që duhet ti ketë aktgjykimi, që në dispozitiv të aktgjykimit të paraqiten të gjitha çështjet të cilat janë ngritur dhe kanë qenë pjesë përbërëse e aktakuzës dhe aktgjykimit për të vërtetuar ekzistimin e veprës penale. Po ashtu dhe çështjet tjera të ngritura në këtë çështje penale të cilat i ka identifikuar kolegji pas mbajtjes së seancës së kolegjit, është dashur që të ketë pasqyrim të drejtë lidhur me gjendjen shëndetësore të akuzuarit, në momentin e kryerjes së veprës penale, të vërtetohet motivi i kryerës së veprës penale, sikurse është shënuar përfitimi pasuror, që duhet të jetë kompatibil me veprën penale të vrasjes së rëndë, nga neni 179 par.1 pika 1.6 e KPK. Në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë ka bërë rikualifikimin juridik nga vepra penale vraje e rëndë, duke pretendua se nuk ka prova të cila e vërtetojnë ekzistimin e veprës penale, për të cilën është akuzuar, por ka ardhur në përfundim se kemi të bëjmë me veprën penale të vrasjes nga neni 178 i KPK, mirëpo nga vlerësimi i përgjithshëm i të gjitha shkresave të lëndës, rezulton se i akuzuari në kohën e kryerjes së verës penale ka qenë me automjetin e të dëmtuarit, pa u vërtetuar arsyeja, se vepra penale ka mundur të kryhet me rrethana të tjera, sikurse pretendon mbrojtësi i të akuzuarit, në gjendje të tronditjes së fortë mendore, e cila duhet të lidhet me gjendjen shëndetësore të akuzuarit K.H., në momentin e kryerjes së të njëjtës. Në këtë çështje penale nga ana e gjykatës së shkallës së parë është abstrahuar elementi cilësues i veprës penale vrasje e rëndë nga neni 179 par.1 pika 1.6 të KPK, që është si element kualifikues i ekzistimit të kësaj vepre penale, mirëpo me rastin e kualifikimit të veprës penale të vrasjes, cilat kanë qenë provat të cilat kanë qu në drejtim të rikualifikimit juridik të veprës penale. Sa i përket raportit të ekspertit Dr.Fahri Drevinja, përkitazi

me gjendjen psikike të akuzuarit, është dashur që të sqarohet se çfarë ka qenë përmbajtja e të njëjtit, pastaj të vërtetohet.

Kolegji i kësaj gjykate ka ardhur në përfundim se të gjitha çështjet e ngritura nga ana e prokurorisë, mbrojtësit së të akuzuarit, përkitazi me ekzistimin e veprës penale është dashur që të sqarohen, sepse vepra penale e vrasjes së rëndë, e vrasjes, si dhe e vrasjes të kryer nga afekt mendor, kanë elemente karakteristike të dallueshme njëra prej tjetrës, kurse në përmbajtje të aktgjykimit nuk janë sqaruar asnjë element karakteristik i asnjë veprë penale, e sidomos është dashur të sqarohet ndodhja e të akuzuarit në automjetin e të dëmtuarit në momentin e kryerjes së veprës penale, e cila ka qenë tronditja e fortë mendore e cila ka mundur të ndikoj apo mos të ndikoj në kryerjen e veprës penale, se a ka pasur revole këtu i akuzuari apo e njëjta ka qenë te viktima dhe e ka marrë prej dorës së tij i akuzuari, se cili ka qenë motivi i kryerjes së kësaj veprë penale, se si ka qenë e mundur që vepra penale të ri kualifikohet nga vepra penale e vrasjes së rëndë, në veprën penale të vrasjes, dhe vrasja është kryer eventualisht nga tronditja e fortë mendore e këtu të akuzuarit, me qëllim që na jep një rikualifikim të jetë vepra penale si tërësi me të gjitha elementet ri kualifikuese. Mundësisht të bëhet një ekspertizë psikologjike dhe psikiatrike të akuzuarit, nga ana e ekspertëve të fushave përkatëse, e më pastaj gjatë punës të nxjerrin edhe prova të tjera, për të cilat mendohet se janë të rëndësishme për të vendosur çështjen penale, ashtu që të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga gjykata e shkallës së dytë të jenë të akceptueshme në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ngase edhe ashtu dispozitat ligjore na obligojnë. Gjatë punës së aktgjykimit duhet pasur kujdes kohën e kryerjes së veprës penale, përkitazi me ligjin e aplikueshëm, e jo të aplikohen dy ligje gjatë një aktgjykimi, ngase KPK, Kodi nr.04/L-082, është në fuqi nga dt.20.04.2014, deri në hyrje në fuqi të KPK, Kod nr.06/L-074, është në fuqi nga dt.13.03.2019, që nënkupton se kodi i mëparshëm është shfuqizuar, kurse në rastin konkret përdoret kodi i përparshëm, kodi i tanishëm që krijon konkluzion në aplikim.

Pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, atëherë i njëjti nuk është shqyrtuar lidhur me pretendimet e tjera ankimore, pasi që është vendosur se duhet të shkoj në rigjykim.

Ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar M.Z., av.Gëzim Kollqaku, tani për tani është jo lëndore.

Ndaj të akuzuarit K.H., është vendosur që të vazhdoj paraburgimin në kuptim të nenit 402 par.5 të KPPK.

Vendimi lidhur me konfiskimin e sendeve që kanë qenë të përfshira në kryerjen e veprës penale është bazuar në kuptim të nenit 366 par.3 të KPPK.

Po ashtu të gjitha vendimet e tjera të marra në këtë çështje penale kanë mbështetjen e duhur ligjore.

Nga arsyet e cekura më lartë, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 402 të KPPK.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.16/2024, të datës 18.03.2024**

**Bashkëpunëtore profesionale, Anëtarët e kolegjit,**  
**Ardianë Morina Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit,**  
**Beqir Kalludra**

**Xhevdet Abazi**